

MBI AUDITIMIT E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, TË USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjencinë e Prokurimit Publik me objekt “Auditimin e Teknologjisë së Informacionit në APP” për periudhën 01.01.2014 deri më datën 30.03.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 168, datë 27.12.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën Nr. 427/10, datë 27.12.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Eduard Ahmeti, Drejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

1. Gjatë auditimit u konstatua se, masat e marra nga APP për sigurimin e Planin e Vazhdueshmërisë së Biznesit (BCP) dhe Planin e Rimëkëmbjes nga Katastrofat (DRP) janë të pa mjaftueshme.

APP nuk zbaton Politikat e Menaxhimit të Ndryshimeve dhe nuk garanton vazhdimësinë e punës për prokurimin elektronik me pasojë ndërprerjen e shërbimit, humbjen e informacionit dhe besueshmërisë në kundërshtim me VKM nr. 710, dt. 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” pika 1 a, b, c ç, d, dh, e, pika 3 dhe pika 4, Planin e Sigurisë së APP-së Nr Prot.3076 Datë 25.02.2009 pika 9.2, *trajtuar në faqen 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

APP të marrë masa administrative dhe organizative për krijimin, testimin dhe rishikimin periodik të Politikave dhe Planeve të Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe Rimëkëmbjes nga Katastrofat (BCP dhe DRP).

Menjëherë

2. Gjatë auditimit u konstatua se në strukturën organizative dhe në detyrat funksionale të stafit të Agjencisë nuk është i rregulluar funksioni që garanton sigurinë e sistemit dhe mbrojtjen e informacionit e të integritetit të të dhënave që disponohen, kjo në kundërshtim me Planin e Sigurisë së Agjencisë, të datës 25.02.2009, Kapitulli 3, pika 3.1, duke krijuar hapësira për qasje të paautorizuar në të dhënat, *trajtuar në faqen 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

Nga ana e APP të marren masat për të plotësuar dhe rregulluar funksionin e “Oficerit të Sigurisë”, plotësim që gjykojmë se do të sjellë eliminimin e risqeve të mundshme operacionale nga mungesa e një funksioni që garanton integritetin e të dhënave dhe

mban përgjegjësi për çdo cënim të sigurisë së të dhënave të disponueshme duke garantuar edhe zbatimin e Planit të Sigurisë së Agjencisë.

Menjëherë

3. Gjatë auditimit u konstatua se nga APP nuk ka politika të mjaftueshme të zhvillimit të Burimeve Njerëzore. Gjykojmë se një faktor i rëndësishëm në mirëfunksionimin e prokurimeve elektronike është profesionalizmi dhe trajnimi i vijueshëm i punonjësve sidomos atyre që garantojnë sigurinë në fushën e teknologjisë së informacionit, *trajtuar në faqen 14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

APP të marrë masa për hartimin e politikave të trajnimit të Burimet Njerëzore në fushën e teknologjisë së informacionit, të vendosi standarde për trajnime të vijueshme të stafit, duke përcaktuar një numër të caktuar ditësh trajnimi për çdo funksion kryesor të lidhur me realizimin me sukses të objektivave institucional.

Në vijimësi

4. Gjatë auditimit u konstatua se, Politikat mbi gjurmët (log-et) e Sistemit të prokurimit nuk zbatohen. Me risk në qasje të paautorizuar në të dhënat, kërcënim të sigurisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mungesë transparence, në kundërshtim me “e-Procurement Security Policy and procedures Manual” Kapitulli 6 “Audit Trail” pika 6.2 “Checking the log files” , *trajtuar në faqen 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

APP të marrë masa për Analizimin e gjurmëve (Log-ve), dhe dokumentimi i këtij procesi, ruajtjen e një kopje të veçantë për tu përdorur në rastet e auditimit si dhe ankimimeve.

Në vijimësi

5. Gjatë auditimit u konstatua se, mbajtja dhe sinkronizimi manual i kohës (orës) të Sistemit të prokurimit nuk garanton transparencën e nevojshme për procedurat e prokurimit. APP nuk zbaton Politikën e menaxhimit të ndryshimeve. në kundërshtim me “Rregullore për Ofrimin e Shërbimeve të Përqendruara Elektronike në Administratën Publike”, pika 1.4.4, *trajtuar në faqen 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

APP të marrë masa për Sinkronizimi automatik të orës së sistemit të prokurimit elektronik me serverin e orës së AKSHI-t.

Menjëherë

6. Gjatë auditimit u konstatua se në APP nuk ekziston një procedure zyrtare e raportimit, menaxhimit ndaj incidenteve, në kundërshtim me Planin e Sigurisë Kap 5.5 “Përgjigja të incidenteve”, *trajtuar në faqen 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

APP të marrë masa për Hartimin e procedurave për evidentimin, raportimin, menaxhimin dhe përgjigjes ndaj incidenteve.

Menjëherë

7. Gjatë auditimit u konstatua se, masat e ndërmarra për Sigurinë Fizike dhe Mjedisore të sistemit të Prokurimit Publik nga APP janë të pamjaftueshme, në kundërshtim me Rregulloren e AKSH-it mbi “Ndërtimin e Dhomës së Serverave”, *trajtuar në faqen 17,18,19,20,21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

APP të marrë masa për ndërtimin e dhomës së serverave në përputhje me rregulloren e AKSH-it.

Menjëherë

8. Gjatë auditimit u konstatua se, masat e ndërmarra në drejtim Backup-it janë të pamjaftueshme dhe nuk japin siguri në mbështetjen e BCP dhe DRP, në kundërshtim kjo me VKM nr. 710, dt. 21.08.2013 dhe me Planin e Sigurisë Nr Prot.3076 Datë 25.02.2009 pika 7.4 “Backup i të Dhënave”, *trajtuar në faqen 22,23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

APP të marrë masa administrative dhe organizative për kryerjen e Backup-it në përputhje me kërkesat e VKM nr. 710, dt. 21.08.2013 dhe me Planin e Sigurisë Nr Prot.3076 Datë 25.02.2009.

Menjëherë

9. Gjatë auditimit u konstatua se, nuk ka vlerësim të raporteve të monitorimit dhe përpilim të raporteve për përmirësimin e infrastrukturës, pa përjashtuar edhe sugjerimet në adresë të infrastrukturës, nuk ka raporte dhe sugjerime për diagnostifikimet e problemeve, nuk mbahen dokumentacione përkatës (Aktkollaudimi, procesverbal), për shërbimet që realizohen sipas kontratës, në kundërshtim me kontratën e shërbimit nr.01, datë 22.09.2014, *trajtuar në faqen 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

Nëpunësi autorizues, referuar Udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu III, pika 42, duhet të nxjerri urdhrin përkatës për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimeve .

Në vijimësi

10. Gjatë auditimit u konstatua se, APP nuk siguron mbështetjen e mjaftueshme për Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët ekonomikë, *trajtuar në faqen 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Rekomandojmë:

Marrjen e masave administrative dhe organizative për sigurimin e mbështetjes me gjithë kanalet e komunikimit për Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë, Publikimi i orarit të kryerjes së këtij shërbimi.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe auditimin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Auditimi është kryer nga:

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 20.01.2015 deri më 25.04.2015 nga audituesit Kozma Kondakçiu, përgjegjës grupi, Yrjada Jahja, Marenglen Sinani, Elisa Metaj më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi z. Alush Zaçe, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve z. Ermal Yzeiraj, si dhe nga Drejtori i Departamentit zj. Manjola Naço.